



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:050756
Datë: 13.06.2024
Numri i dokumentit: 05837641

Ac.nr.1749/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), adresa: Sheshi Bill Kllinton, kati i II, nr.5, 10000 Prishtinë, kundër të paditurit N. A., rr. E. fshati J., Komuna e Ferizaj, objekti i kontestit kompensim i dëmit, vlera e objektit të kontestit 496.94 €, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.728/20, i datës 09.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit N. A., nga fshati J., Komuna Ferizaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.728/20, datë 09.11.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.728/20, i datës 09.11.2020, ka vendosur si në vijim: *Aprovohet kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A (KEDS) nga Prishtina dhe Obligohet i padituri N. A. nga fshati J., që paditëses në emër të kompensimit të dëmit t'ia paguaj shumën prej 496.94 euro për shkak të fitimit të pa ligjshëm, përmes shfrytëzimit të energjisë elektrike në mënyrë të pa autorizuar. II. Secila pale i bart shpenzimet e veta të procedurës.*

Kundër këtij aktgjykimi i padituri në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke mos përmendur asnjë shkak ankimor, porse sipas tij nuk ka njohuri se ai ka keq përdorë ndonjëherë energjinë elektrike.

Në shkresa të lëndës nuk mund të gjendet se pala paditëse ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se pala paditëse me datë 05.05.2020 ka paraqitur padi kundër të paditurit për kompensimin e dëmit material, lidhur me dëmin e shkaktuar, për shkak të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike me qëllim që paditësi vetes ti sjell pasuri të kundërligjshme.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se përmes procesverbalit nr.20250 datë 04.11.2013 është vërtetuar se është manipuluar njëtori për matjen e energjisë, ngase mungon një plumbë. Kurse nga leximi i faturës së datës 29.11.2013 është vërtetuar se energjia e shpenzuar është në lartësi 496.94€. Ka arsyetuar se është vërtetuar se ndaj paditësit ka pasur të ngrit kallëzim penal, mirëpo ai është hedhur për shkak të parashkrimit të ndjekës penale. Më tej ka arsyetuar se është vërtetuar se është manipuluar me numrat e orës së rrymës, se ekzistojnë shenjat e gishtave ne numrat 3,4,5 dhe se më tej vërtetohen edhe me foto dokumentacion. Nga provat e administruara dhe gjendjes faktike të vërtetuar del përfundimi se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar, respektivisht se i padituri ka obligim që KEDS-it t'ia paguaj në emër të dëmit material shumë prej 496.94 euro.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k), dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Nuk kishte pretendim ankimor specifik për sa i përket shkeljeve të dispozitave procedurale, prandaj gjykata kufizohet në vetëm ato që kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadiës e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për themelësinë e kërkesëpadiës, ndërsa lartësinë e kërkesëpadiës e ka është provuar përmes faturës së të paditurës dhe procesverbalit të paditurës datë 31.10.2013, përmes të cilit është bërë evidentim i intervenim

në njëisor elektrik, si dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për shumën e aprovuar. Ndonëse pala e paditur nuk ka bërë pretendim të qartë ankimor për sa i përket vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, gjykata zbërtheu të njëjtën me qëllim aplikimit të së drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë.

Si rrjedhojë e vërtetimit të gjendjes faktike dhe peshimit të duhur të fakteve dhe provave, gjykata ka arritur që gjendjen faktike të kualifikoj drejtë në normat materiale të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili në nenin 137 rregullon “*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)*”. Kurse nenit 169 par. 1 rregullon “*Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi*”. Gjukata ka vlerësuar se i padituri duke shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, me qëllim që t’i sjellë vetes pasuri të kundërligjshme, i ka shkaktuar dëm paditëses në vlerë prej 496.94€. Prandaj, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartë cituara, me gjendje të vërtetuar faktike, drejtë ka gjykuar kur ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke detyruar të paditurin që paditëses t’ia paguaj detyrimin.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykimi dhe vendosja e kontestit bëhet në bazë të provave që janë administruar, kurse sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, është paraparë se “*palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”, andaj gjykata është e lidhur vetëm me propozimet dhe provat të cilat i propozojnë palët ndërgjyqëse. Pala e paditur nuk ka paraqitur propozime për ndonjë mjet provues që do të kontestonte kërkesëpadinë. Në këtë natyrë të kontesteve, gjykata nuk ka rol aktiv për nxjerrjen e ndonjë mjeti provues, porse ajo do të vlerësoj provat që ndërgjyqësit ofrojnë, në këtë mënyrë gjykata e shkallës së parë ka përfunduar duke aplikuar parimin e barrës së të provuarit.

Në analizim të pretendimeve ankimore, Gjukata e Apelit nuk ka gjetur ndonjë vlerësim tjetër, për vendosjen ndryshe nga siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjukatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.1749/2021, datë 13.06.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjuqtari
Dardan Kadolli